V E N D I M
Nr.148, datë 25.3.1994

PËR MIRATIMIN E PËRPARËSIVE TË STRATEGJISË SË ZHVILLIMIT TË SISTEMIT ELEKTROENERGJETIK TË VENDIT

Me propozimin e Ministrisë së Burimeve Minerare dhe Energjetike, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Të miratojë përparësitë e zhvillimit të sektorit elektroenergjetik të vendit për periudhën 1994-1996, në përputhje me studimet e kryera për këtë qëllim, sipas këtij rendi:

a) Zvogëlimi i humbjeve joteknike të energjisë elektrike.

b) Rehabilitimi dhe rinovimi i hidrocentraleve të Fierzës, Vaut të Dejës, Ulzës, Shkopetit dhe Selitës.

c) Ristrukturimi i sistemit të transmetimit të sistemit elektroenergjetik të vendit.

ç) Ristrukturimi i rrjetit elektrik të shpërndarjes.

d) Ristrukturimi dhe modernizimi i sistemit të drejtimit të sistemit elektroenergjetik të vendit.

2. Ministria e Burimeve Minerare dhe Energjetike, Komiteti Kombëtar i Energjisë dhe Këshilli Kombëtar i Ujërave ngarkohen që brenda vitit 1994 të kryejnë studimin për prognozimin e zhvillimit të ngarkesave elektrike për periudhën deri në vitin 2010 dhe të paraqesin për miratim në Këshillin e Ministrave, sipas rendit përparësor, ndërtimin e hidrocentraleve e të termocentraleve të reja.

3. Ministria e Financave dhe Ministria e Burimeve Minerare dhe Energjetike ngarkohen që brenda muajit prill 1994 të paraqesin për miratim në Këshillin e Ministrave projektvendimin për strukturën e re të çmimeve dhe tarifave të energjisë elektrike, duke synuar kalimin drejt kostos ekonomike të saj.

4. Të miratojë në parim "Marrëveshjen ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Konfederatës Zvicerane për dhurimin e një asistence financiare", për të pranuar nga Qeveria Zvicerane një kontribut financiar në formë ndihme pa rikthim për projektin e ristrukturimit të hidrocentraleve dhe angazhimin e saj për të kontribuar në projektin për zvogëlimin e humbjeve joteknike.

5. Të pranojë në parim kontributin financiar të Qeverisë Austriake në formë ndihme pa rikthim për financimin e projektit të rehabilitimit të hidrocentraleve.

6. Për sigurimin e burimeve të financimit për realizimin e përparësive të zhvillimit të sektorit elektroenergjetik të vendit, sipas pikës 1 të këtij vendimi, ngarkohen:

a) Ministria e Financave për dhenien e garancive shtetërore.

b) Ministria e Burimeve Minerare dhe energjetike në rolin e oponentit tekniko-ekonomik për argumentimin e domosdoshmërisë së realizimit të projekteve.

c) Korporata Elektroenergjetike Shqiptare në rolin e huamarrësit përgjegjës për shlyerjen e financimeve sipas kushteve të kontratave.

7. Ministria e Financave ngarkohet që brenda datës 15 prill 1994 të hartojë procedurën e punës, në përputhje me legjislacionin dhe standardet më të mira, për negocimin sipas roleve të pikës 6 me institucionet financiare ndërkombëtare që kanë shprehur angazhim për financimin e projekteve të zvogëlimit të humbjeve joteknike, rehabilitimin e hidrocentraleve, ristrukturimin e sistemit energjetik etj., si Banka Botërore, Banka Islamike, Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, Fondi Japonez i Bashkëpunimit Ekonomik me Jashtë etj., për të arritur marrëveshje kreditimi sa me të leverdishme.

8. Ministria e Financave dhe Ministria e Burimeve Minerare dhe energjetike, duke marrë në konsideratë politikën e re të çmimeve të energjisë elektrike, si dhe bilancin ekonomiko - financiar të veprimtarisë së KESH-it, të propozojnë dhe të marrin, në përputhje, me kompetencat, masat e dosmosdoshme për të mundësuar aftësitë financiare të KESH-it për shlyerjen prej tij në afat të kredive, interesave dhe vleftës kundërparti.

9. Ministria e Burimeve Minerare dhe Energjetike ngarkohet që brenda vitit 1994 të mundësojë privatizimin e sektorit të shitjes së energjisë elektrike nëpërmjet kontratave të shërbimit ose formave të tjera me të përshtatshme, në mënyrë që ky shërbim deri në vitin 1996 të shtrihet në mbarë

vendin.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi